

Nr. _____ prot

Tiranë, më _____._____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburanti benzinë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (C.P.V.): 09132000-3
”Benzinë”; 09132100-4 “Benzinë pa plumb”

VLERA E FONDIT LIMIT: 13,634,290.19 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë pikë nëntëmbëdhjetë) lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, ”Operatori i shërbimeve të integruara të sterilizimit” sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, nenit 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilat parashikohet se:

- Neni 82, i LPP-së, pika 1: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

- Neni 83 i LPP-së: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 40 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave" dhe pikën 1 të nenit 43 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve" Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet se: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 të VKM Nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit**. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë, për furnizimin, i cili do të kryhet sipas kërkesave periodike të autoritetit kontraktor, nëpërmjet kartave elektronike në pikat e shitjes me pakicë të operatorit ekonomik, me të paktën një stacion furnizimi në secilin prej akseve të mëposhtme:

Aksi rrugor
Tiranë – Durrës – Kavajë – Lushnjë – Fier – Vlorë

Aksi rrugor
Tiranë – Krujë/Fushë-Krujë – Lezhë – Shkodër
Tiranë – Elbasan – Përrenjas – Librazhd – Korçë
Tiranë – Fier – Tepelenë – Gjirokastrë – Sarandë
Tiranë – Burrel – Dibër

të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (në pronësi ose kontratë qiraje të noterizuar ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga Q.K.B).

Argumentimi: Kërkesa për sigurimin e një numri minimal pikash furnizimi me benzinë pa plumb është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me qëllim garantimin e realizimit me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave operative të Autoritetit Kontraktor. Në zbatim të VKM-së nr. 845, datë 30.12.2025, për krijimin e shoqërisë “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a. (OSHIS sh.a.), shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në funksion të ofrimit të shërbimeve të integruara të sterilizimit për institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë. Për përmbushjen e këtyre detyrimeve, OSHIS sh.a. ka nevojë për mjete transporti të cilat përdoren për kryerjen e aktiviteteve operative, koordinimin dhe monitorimin e shërbimeve, transportin e materialeve dhe seteve, si dhe trajtimin dhe transportin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Duke qenë se veprimtaria e Autoritetit Kontraktor shtrihet në 29 spitale publike dhe në të gjitha qendrat shëndetësore në territorin e Republikës së Shqipërisë, mjetet e transportit janë në lëvizje në të gjithë territorin, pasi këto mjete do të lëvizin për shërbime të integruara të sterilizimit dhe shërbimit të ofrimit të kontrollit mjekësor bazë. Për këtë arsye, lind nevoja për garantimin e aksesit të shpejtë dhe të vazhdueshëm në pika furnizimi me benzinë, pa shkaktuar devijime të panevojshme nga itineraret funksionale, vonesa në kryerjen e detyrave apo rritje të kostove operative. Kërkesa për stacionet e furnizimit, është e lidhur drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit dhe nevojat reale të Autoritetit Kontraktor. Kjo kërkesë synon të sigurojë mbulim të mjaftueshëm territorial, fleksibilitet në furnizim dhe vazhdimësi të përdorimit të mjeteve gjatë gjithë periudhës së kontratës. Gjithashtu, kërkesa që pikat e furnizimit të jenë në pronësi, me qira ose të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar të operatorit ekonomik, synon të garantojë që operatori ekonomik disponon të drejtën ligjore dhe kontrollin e nevojshëm mbi këto pika për realizimin e detyrimeve kontraktuale gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes.

Për sa më sipër, kriteri i përcaktuar konsiderohet i lidhur dhe proporcional me objektin e prokurimit dhe me nevojat operative të OSHIS sh.a., duke synuar garantimin e furnizimit në kohë dhe pa ndërprerje me benzinë për automjetet e shoqërisë, si dhe vijimësinë e veprimtarisë së saj në të gjithë territorin ku ushtron aktivitetin.

2.3.3 Këto stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve të cituara më lart detyrimisht duhen të jenë të pajisur me:

- Licence/Autorizim të lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë;
- Leje mjedisore e tipit B sipas legjislacionit, të lëshuar nga Q.K.L;

- Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (O.M.V.K.);
- Certifikatë e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, shkronja “a” dhe pika 8, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kërkesa që stacionet e karburantit të jenë të pajisura me dokumentacionin përkatës ligjor dhe teknik është vendosur në funksion të garantimit të sigurisë publike, mbrojtjes së mjedisit dhe cilësisë së shërbimit. Tregtimi i karburanteve është një aktivitet me risk të shtuar dhe i rregulluar nga legjislacioni specifik, ndaj Autoriteti Kontraktor me kete kerkese sigurohet që operatorët ekonomikë ushtrojnë këtë aktivitet në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Dokumentacioni për stacionet e tregtimit me pakice të karburanteve është kerkuar sipas parashikimit të pikës II “Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, i ndryshuar me ane të se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale si dhe dokumentacionin shoqëruar, për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në kushtet kur kemi të bëjmë me furnizim me kartë elektronike. Kërkesa që këto dokumente të jenë brenda afatit të vlefshmërisë në datën e hapjes së ofertave garanton që operatori ekonomik është në përputhje aktuale me legjislacionin dhe ka kapacitet real për realizimin e kontratës.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga I.SH.T.I., që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standardeve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë përgjatë vitit të fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar ku citohet se: Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, shkronja ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit në fuqi duke mos patur penalitete për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e hapjes së ofertave.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analiza të lëshuar nga I.SH.T.I. të cilat duhet të jenë lëshuar brenda 6 muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për testime/rezultatet zyrtare, të lëshuara nga

institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar nga AK brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Objekti i kontratës është furnizimi me benzinë pa plumb (Premium Unl 10 ppm) për nevojat e automjeteve të shoqërisë “OSHS” sh.a.

Furnizimi do të kryhet sipas kërkesave periodike të autoritetit kontraktor, nëpërmjet kartave elektronike në pikat e shitjes me pakicë të operatorit ekonomik, me të paktën një stacion furnizimi në secilin prej akseve të mëposhtme:

Aksi rrugor	Spitalet që mbulohen me shërbim nga centralet e sterilizimit të Operatorit të Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit sh.a.
Tiranë – Durrës – Kavajë – Lushnje – Fier – Vlorë	Spitali Durrës, Spitali Kavajë, Spitali Lushnje, Spitali Fier, Spitali Vlorë, Centrali në Spitalin e Durrësit, Centrali në Spitalin e Lushnjës, Centrali në Spitalin e Vlorës, Magazina Qendrore e “OSHS” sh.a., Gjokaj, Vorë.
Tiranë – Krujë/Fushë-Krujë – Lezhë – Shkodër	Spitali Krujë, Spitali Lezhë, Spitali Shkodër, Spitali Pukë, Spitali Rrëshen, Centrali në Spitalin e Shkodrës.
Tiranë – Elbasan – Përrenjas – Librazhd – Korçë	Spitali Elbasan, Spitali Librazhd, Spitali Gramsh, Spitali Korçë, Spitali Pogradec, Spitali Ersekë.
Tiranë – Fier – Tepelenë – Gjirokastrë – Sarandë	Spitali Fier, Spitali Gjirokastrë, Spitali Sarandë, si dhe lëvizjet e nevojshme drejt zonës jugore për transportin e materialeve dhe mbetjeve spitalore.
Tiranë – Burrel – Dibër	Spitali Burrel, Spitali Dibër/Peshkopi, Centrali në Spitalin e Burrelit, Centrali në Spitalin e Peshkopisë.

Specifikimet teknike të benzinës pa plumb:

Benzina (Premium Unl 10 ppm) duhet të jetë në përputhje me standardin SSH EN 228:2025 ose ekuivalent, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, e cila është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Shënim: Për çdo standard ose emërtim të përmendur pranohet edhe ekuivalenti i tij.

Nr.	Autoriteti kontraktor	Mënyra e furnizimit	Njësia	Sasia e pritshme	Kohëzgjatja
1	Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit sh.a.	me kartë elektronike	litër	88,037	36 muaj

Afati i lëvrimit: 36 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër. Furnizimi do të realizohet sipas kërkesave periodike të autoritetit kontraktor, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës/kontratave deri në përmbyshjen e nevojave, brenda sasisë së pritshme dhe pa tejkaluar vlerën maksimale të marrëveshjes kuadër.

KUJDES:

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë listuar:

- a) Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me karta elektronike të personalizuar në të gjitha qytetet, të çdo automjeti të AK, me të gjitha shpenzimet e mbuluara nga Operatori Ekonomik sipas kërkesave të AK. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- b) Bazuar në Vendimin Nr. 561, datë 29.07.2016, të Këshillit të Ministrave “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, me ndryshimet e mëvonshme të bëra nga autoritetet shtetërore kompetente, Operatorët ekonomik duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.
- c) Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vetë AK. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në pikën 1 të VKM Nr.561, datë 29.7.2016 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të Karburantit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj. Karta elektronike përfshin identifikimin e mjetit, kontrollin e sasisë dhe gjurmueshmerinë e furnizimit të mjetit. Identifikimin e mjetit dhe transparencës së lëvrimit të sasive të karburantit. Fotografimi i mjetit konsiston në fotografimin e targës së makinës, momentin e furnizimit të automjetit dhe pikën e karburantit ku furnizohet automjeti me qëllim verifikimin e furnizimit të mjeteve gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci për AK se furnizimi do të realizohet me karta elektronike sipas kërkesave të parashikuara më lart. Te gjitha pikat e parashikuara më lart ofrohen nga faqja e menaxhimit të karburantit nëpërmjet të cilit Autoritetet Kontraktor menaxhon shpërndarjen dhe informohet në çdo kohë me lëvizjet që kryhen me sasine të karburantit të prokuruar. Faqja e menaxhimit të karburantit vihet në dispozicion të Autoritetit Kontraktor menjëherë pas lidhjes së kontratës dhe nëpërmjet kësaj

faqe Autoriteti menaxhon sasine e karburantit nga lidhje e kontratës/marrëveshjes kuadër deri në përfundimin e tyre duke garantuar transparencë totale në menaxhimit e sasive dhe shpërndarjes së karburantit . Vendosja e këtij kriteri është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor, në përputhje me nenin 36 “*Specifikimet teknike*” të ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*”, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Benzina (Premium Unl 10 ppm) duhet të jetë në përputhje me standardin SSH EN 228:2025 ose ekuivalent, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, e cila është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Në specifikimet teknike nuk përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve dhe çdo referime i tillë shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT: